

Prokurimi i Punimeve për Deponitë në Kosovë
Deponitë në Gjilan, Pejë, Prizren, Podujevë dhe Istog

Njoftim për Parakualifikim

Parakualifikim – për Tenderim Ndërkombëtar me Konkurrencë

12.02.2026

Shteti	Republika e Kosovës
Autoriteti Kontraktues	Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK) Rr. Gazmend Zajmi, Nr. 41 10 000 Prishtinë, Kosovë
Financimi	KfW Entwicklungsbank
Numri i Referencës	BMZ Nr. 2016 675 91, 2016 700 41, 2018 675 71, 2020 679 32
Nr. i Prokurimit	513598
Lënda	Programi për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta në Kosovë II – IV
Afati për dorëzim	31.03.2026
Gjuha	Anglisht

Projekti:

Programi për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta II – IV, i financuar bashkërisht nga KfW, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe kontributet nga Bashkimi Evropian, adreson nevojat kritike të infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave të ngurta në gjithë Kosovën dhe synon krijimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe miqësor ndaj mjedisit për menaxhimin e mbeturinave, duke harmonizuar praktikatat kombëtare me standardet e BE-së.

Projekti mbulon katër rajonet administrative: Prishtinë, Gjilan, Pejë dhe Prizren, si dhe pesë lokacione infrastrukturore, me fokus në zgjerimin e deponive ekzistuese, përmirësimin e infrastrukturës së deponive dhe mbylljen e një vendgrumbullimi të pakontrolluar.

Shërbimet e Kërkuara (Një Kontratë e Vetme):

1. Deponia e Prizrenit
Zgjerimi i deponisë rreth 80,000 m ²
Ndërtimi i objekteve dhe infrastrukturës
Mbyllja dhe mbulimi i pjesëve të qelizës ekzistuese
Impianti për Trajtimin e Ujërave të Ndotura – Reaktor Biologjik me Membranë (MBR)
Degazifikimi i deponisë dhe trajtimi i gazit të deponisë
Furnizimi me pajisje për operimin e deponisë

2. Deponia e Gjilanit
Zgjerimi i deponisë rreth 54,000 m ²
Ndërtimi i objekteve dhe infrastrukturës
Mbyllja dhe mbulimi i pjesëve të qelizës ekzistuese me zhvendosje të mbeturinave rreth 95,000 m ³ , profilim dhe ngjeshje
Impianti për Trajtimin e Ujërave të Ndotura – Reaktor Biologjik me Membranë (MBR)
Degazifikimi i deponisë dhe trajtimi i gazit të deponisë
Furnizimi me pajisje për operimin e deponisë
3. Deponia e Pejës
Zgjerimi i deponisë rreth 50,600 m ²
Ndërtimi i objekteve dhe infrastrukturës
Mbyllja dhe mbulimi i pjesëve të qelizës ekzistuese me zhvendosje të mbeturinave rreth 100,000 m ³ , profilim dhe ngjeshje
Impianti për Trajtimin e Ujërave të Ndotura – Reaktor Biologjik me Membranë (MBR)
Furnizimi me pajisje për operimin e deponisë
4. Deponia e Podujevës
Rehabilitimi i pjesëve të qelizës ekzistuese
Ndërtimi i objekteve dhe infrastrukturës
Impianti për Trajtimin e Ujërave të Ndotura – Reaktor Biologjik me Membranë (MBR)
Furnizimi me pajisje për operimin e deponisë
5. Vendgrumbullimi i Istogut
Mbyllja dhe mbulimi i të gjithë vendgrumbullimit rreth 30,000 m ²
Degazifikim pasiv

Afati kohor për zbatimin e punimeve është 24 muaj. Periudha e njoftimit për defekte do të jetë 12 muaj pas lëshimit të Certifikatës së Marrjes në Dorëzim.

Parakualifikimi i firmave/konzorciumeve me përvojë do të zhvillohet sipas “Udhëzimeve të KfW për Prokurimin e Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve të Ndërlidhura në Kuadër të Bashkëpunimit Financiar me Vendet Partnere” (referojuni faqes zyrtare www.kfw.de).

Për informata të mëtejshme lidhur me parakualifikimin, ju lutemi kontaktoni me shkrim: Znj. Anjeza Alaj
E-mail: projectprocurement@kmdk-ks.org

Dokumentet e Parakualifikimit do të shpërndahen në mënyrë elektronike, pas kërkesës me shkrim në emailin e mësipërm.